



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality**  
**Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport**



Datë: 13/03/2024  
Dragash

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

11 Nr. Br. 100/01-8124/24  
13-03-2024  
**Dragash - Dragaš**

**THIRRJE PUBLIKE**

Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e sportit dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare:

• **Në fushën e sportit**

- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive
- Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja

• **Vlerësimi**

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për Kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Vlerësimi do të bëhet sipas:**

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë artistike të projektit
6. Originalitetit të projektit

**Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:**

- Formulari i aplikacionit për projekt / program
- Formulari i propozim-buxhetit
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
- Formulari për konflikt interesi
- Dokumenti i identitetit (fotokopje)
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje)
- Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
- Dëshmi të implementimit projekteve / programeve të ngjashme

Formulari për aplikim mund të merret në web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **13/03/2024 deri më 02/04/2024** (15 ditë punë). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

**Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Prokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për: Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.**

## Aplikimet

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit.
4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantet, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

## Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport

**Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport**  
**Drejtoresha**  
**Liridona Misinaj**

